

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE, me gjyqtarin Bajram Miftari, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit “D. A.” sh.p.k me seli në S., Komuna e S., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit N. B., kundër të paditurës N.T.N “U.” me seli në S. e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor M. E., për shkak të borxhit, vlera e kontestit 20.330.00 €, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor të datës 20.10.2015, me datën 02.11.2015, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. SHFUQIZOHET aktvendimi i kësaj gjykate, për caktimin e përmbarrimit, E.nr.224/13, i dt. 21.03.2013, dhe abrogohen veprimet e ndërmarra në procedurë përmbarrimore

II. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “D. A.”, me seli ne fshatin S., Komuna e S. e paraqitur kundër të paditurit “N.T.N. “U.” me seli ne S., me të cilën paditësi ka kërkuar nga i padituri qe në emër te punëve te kryera në rregullimin e rrugës Vraniq-Mushtisht t’ia paguaj borxhin në shumën prej 20.330.00 €, me kamatë ligjore e cila do të llogaritet nga dita e arritjes së faturës për pagesë, e deri në pagesën definitive të borxhit.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A K T V E N D I M

I. Refuzohet propozimi i të autorizuarit te paditësit për kthimin në gjendjen e mëparshme.

A r s y e t i m i

Rrethanat procedurale të çështjes

Kreditori “D. A.” sh.p.k, me seli ne S., Komuna e S. me datën 04.03.2013, ka paraqitur propozim për përmbarrim, sipas dokumentit autentik, kundër të debitorit N.T.N “U.” me seli në S., për pagimin e borxhit në shumën prej 20.330.00 €, me kamatë prej 3.5% në vit.

Debitori N.T.N “U.”, me datën 05.04.2013, ka paraqitur prapësim kundër aktvendimit për caktimin e përmbarrimit. Në prapësim e ka theksuar se me kreditorin asnjëherë nuk ka pasur marrëveshje, si dhe i ka kontestuar faturat mbi të cilat është lejuar përmbarrimi me pretendimin se janë pa numër dhe pa datë, i ka propozuar gjykatës qe të anuloj aktvendimin për përmbarrim.

Në seancën përgatitore te dt. 21.07.2015, gjykata ka shfuqizuar aktvendimin për lejimin e përmbarrimit te kësaj gjykate E.nr. 224/13, të dt. 21.03.2013, dhe lëndën e ka trajtuar si lëndë kontestimore.

Përfaqësuesi ligjor i paditësit në seancat dëgjimore te mbajtura pranë kësaj gjykate ka deklaruar se paditësi me të paditurin kanë qenë në raporte kontraktuese, ku paditësi ka kryer gërmime me bager në rrugën Vraniq-Mushtisht. Për këto shërbime paditësi ka lëshuar dy fatura me nr. 9/12 me çmimin prej 20.330.00 €, dhe një faturë tjetër me vlerë 15.000 €, dhe se fatura me nr. 9/12 nuk është paguar nga i padituri, ndërsa fatura tjetër është paguar. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se qëndron pranë pretendimeve në padi dhe deklarimeve nga seancat e kaluara, ka shtuar se nga provat e shqyrtuara është vërtetuar se i padituri i ka borxh paditësit shumën prej 20.330.00 €, dhe i ka propozuar gjykatës qe kërkesë padinë e paditësit ta miratoj në tërësi si te bazuar.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës gjatë seancave dëgjimore të mbajtura pranë kësaj gjykate ka deklaruar se i padituri nuk ka qenë në raporte kontraktuese me paditësin për gërmimin dhe shtruarjen e rrugës Vraniq-Mushtisht. Ka shtuar se për shtrimin e kësaj rruge paditësi ka qenë në raporte kontraktuese me një palë të tretë, përkatësisht me firmën “M.” me seli në M..

Në seancën e dt. 20.10.2015 nuk ka prezantuar i autorizuari i të paditurit, edhe pse ishte ftuar nëpërmjet procesverbalit nga seanca e kaluar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, dhe rrjedhimisht seanca është mbajtur në mungesë të palës së paditur, konform dispozitave të nenit 423 pika 4 e LPK-së.

Gjendja faktike e konstatuar

Në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata ka bërë administrimin e provave të lëndës, si në vijim: ka lexuar faturën me nr. 9/12 e datës 25.06.2012; specifikacionin- përshkrimin e punimeve i hartuar nga pala paditëse; pasqyrën tabelare për dërgesat e artikullit- zhavorrit me shenjën FR0-60.

Duke vlerësuar me ndërgjegje secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike: se paditësi më të paditurin nuk kanë qenë në raporte kontraktuese, dhe se provat e prezantuara nga pala paditëse, e të shqyrtuara nga gjykata, janë prova jo të plota dhe jo bindëse nga gjykata mund të konkludonte ekzistimin e raportit kontraktues, në mes të paditësit me të paditurin nga mund të rridhnin të drejta dhe detyrime të ndërsjellata. Një gjendje të tillë faktike gjykata e konstatoj edhe nga fakti se paditësi nuk e prezantoi kontratën e lidhur me të paditurin për punimin e rrugës Vraniq-Mushtisht edhe përkundër deklarimeve të tij gjatë rrjedhës së procedurës së njëjti e posedon një kontratë të tillë.

Arsyetimi ligjor

Me dispozitat e nenit 630 të (LMD-së) është paraparë se kontrata mbi ndërtimin është kontratë e sipërmarrjes me të cilin zbatuesi i punimeve obligohet që sipas projektit të caktuar të ndërtoj në afatin e caktuar, në objektin e taktuar, në tokën e caktuar, apo në një tokë të tillë respektivisht në objektin ekzistues të kryej punime të tjera ndërtimi, ndërsa porositi obligohet që për këtë të paguaj shpërblimin e caktuar. Kontrata mbi ndërtimin duhet të lidhet në formë të shkruar, ndërsa neni 70 i (LMD-së) parasheh se kontrata që nuk është lidhur në formën e parashikuar nuk ka efekt juridik për palët kontraktuese.

Me nenin 7 të (LPK-së) është paraparë se palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen fakte të tilla, ndërsa në nenin 322 të (LPK-së) është paraparë që po që se nga provat e marrura nuk mund të konstatohet me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit të tillë do të përfundoj duke aplikuar rregullat mbi barrën e provave.

Nga provat e prezantuara gjatë rrjedhës së kësaj procedure kontestimore pala paditëse nuk kishte prezantuar kontratën mbi ndërtimin, nga mund të shiheshin të drejtat dhe detyrimet e ndërgjyqësve siç janë mënyra e kryerjes së punimeve, koha e kryerjes, si dhe mënyra e pagesës për punën e kryer në të cilën pretendonte paditësi, e njëjta ka prezantuar faturën me nr. 9/12 e datës 25.06.2012, specifikacionin- përshkrimin e punimeve i hartuar nga vet pala paditëse, pasqyra tabelare për dërgesat e artikullit- zhavorrit me shenjën FR0-60, prova të cilat sipas bindjes së gjykatës nuk janë prova të plota dhe bindëse për të vërtetuar faktin e ekzistimit të raportit kontraktues në mes palëve ndërgjyqëse, andaj nga gjendja faktike e vërtetuar si dhe nga dispozitat e cituara më lartë, gjykata kërkesëpadinë e paditësit e ka refuzuar në tërësi si të pazuar.

Në nenin 132 të LPK-së është paraparë se gjykata nuk hap fare shqyrtim lidhur me kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme, po qe se vëren se faktet mbi te cilat mbështetët propozimi janë te pa justifikueshme, dhe kur gjykata ka prova te mjaftueshme në dosjen e lëndës për dhënën e vendimit sipas propozimit, andaj duke u bazuar në dispozitën e nenit 132 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të te këtij aktvendimi.

Shpenzimet procedurale

Me nenin 463.1 të LPK-së, është përcaktuar se për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendos vetëm me kërkesën e specifikuar të palës. Meqenëse në këtë çështje kontestimore, pala e paditur në procedurë nuk ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe nuk e ka bërë specifikimin e tyre, gjykata nuk vendosi për kompensimin eventual të tyre, por në pajtim me nenin 463.1 të LPK-së, vendosi që secila palë të bartë shpenzimet e veta.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Ekonomike
I.C.nr.485/2013, me datën 02.11.2015

Gjyqtari,
Bajram Miftari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të tij